



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 70

Prishtinë, më 11.03.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 25.02.2013;
3. Shqyrtimi i raportit të Ministrit të Punëve të Brendshme, për situatën e sigurisë në Kosovë
4. Njoftim rreth vizitës së delegacionit të Komisionit nga data 4 – 5 mars në Bruksel
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- E filloi takimin e radhës së Komisionit duke kërkuar nga anëtarët e tij pajtimin e tyre për miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u aprovua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të Komisionit të mbajtur më 25.02.2013

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes, të Komisionit, të mbajtur më **25.02.2013**. Procesverbali u aprovua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i raportit të Ministrit të Punëve të Brendshme, për situatën e sigurisë në Kosovë

Kryetari i Komisionit- Sipas vlerësimit nga ana Komisionit për situatën e sigurisë është rënë dakord që të kërkohej nga Ministri i Punëve të Brendshme raport mbi ngjarjet e fundit, incidentet që kanë ndodhur dhe veprimet serike në Veriun e Kosovës, të cilat cenojnë jetën e qytetarëve atje, rendin publik dhe shkelin ligjin.

Informata e ardhur është një përshkrim i ngjarjeve dhe incidenteve të cilat kryesisht janë të nxitura për shkak të bisedimeve që po vazhdojnë, sepse nga njëra anë kemi qasje pozitive për bisedimet që po zhvillohen dhe në anën tjetër kemi sulme ndaj qytetarëve që cenojnë integritetin e territorial, ligjshmërinë në Kosovë, prandaj konsiderojmë se duhet të kemi një analizë si Komision.

Rexhep Selimi- Për raportin e Ministrit të MPB-së, kam disa vlerësime për mënyrën se si është bërë vlerësimi i situatës së sigurisë në Veri të Kosovës. Fillimisht, vlerësimi i situatës konsiderohet si e tensionuar, prandaj konsideroj se fjala “*e tensionuar*” nuk është vlerësim real, pasi në paragrafin vijues të këtij raporti thuhet se në tensionimin e situatës politike të sigurisë në vazhdimësi janë duke ndikuar strukturat ilegale dhe grupet kriminale.

Struktura të tilla nuk e tensionojnë situatën siç është vlerësuar në këtë raport por ato bëjnë shkelje të sovranitetit të Kosovës, dhe një shkelje e tillë nuk do të duhej të vlerësohej me një term kaq të butë si fjala “*tension*”. Në paragrafët vijues ka kontradikta, nga përshkrimi paraprak në atë vijues, citoj raportin “*Në dy pikat kufitare të Veriut të Kosovës, në Jarinjë dhe Bërnjak nuk ka ndonjë incident apo problem të theksuar*”. Konsideroj se konstatimi i tillë nuk është real, pasi situata në këtë pjesë është problematike.

Gjithashtu në paragrafin vijues bëhet fjalë për strukturat ilegale serbe në veri dhe faktit se këto struktura ilegale, nuk pajtohen që në të dy pikat e kalimit kufitar në Veri të Kosovës të vendosen doganat e Kosovës. Për këtë arsye vlerësoj se ky është më shumë se incident, sepse në vazhdimësi janë duke u organizuar bllokime të këtyre dy pikave kufitare, dhe ky raport nuk është adekuat sepse kjo gjendje në këtë raport vlerësohet si problematike.

Në raport vlerësohet si arritje kur me datë 24.02.2013 në orën 16:30, në mënyrë të organizuar është bërë transporti rrugorë i zyrtarëve policor në pikën kufitare në Jarinjë. Ky zhvillim nuk mund të konsiderohet si arritje, marrë parasysh që ka ndodhur vetëm kësaj radhe. Tutje në vlerësimin e situatës dhe prezencës së institucioneve ilegale në Veri thuhet: *“bazuar në të gjitha vlerësimet e Policisë së Kosovës incidentet e fundit janë të orkestruara nga strukturat ilegale të sigurisë me të vetmin qëllim”*.

Strukturat e tilla nuk e kanë të vetmin qëllim që ta mbajnë të tensionuar gjendjen atje, por dihet qëllimi politik e strategjik i Serbisë përmes këtyre strukturave ilegale. Si dhe përshkrimi i situatave të tensionuara me karakter ndër etnik që përmendet në këtë raport ku në paragrafin e fundit thuhet se: *“është shtuar prezenca e policisë në lagjet me popullatë të përzier me qëllim të parandalimit të incidenteve me karakter ndëretnik”*. Vlerësimi i problemeve me karakter ndëretnik në këtë pjesë të Kosovës është shmangieje e problemeve reale që ka në këtë pjesë të vendit, pasi nuk ka probleme ndëretnike por në veri kemi probleme mes grupeve dhe institucioneve të Serbisë, që veprojnë ilegalisht në Republikën e Kosovës.

Goran Marinkovic- Për raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, konsideroj se është përshkruar dhe në disa segmente tendencioz, pasi disa raste që kanë ndodhur më herët nuk janë të përfshira në këtë raport. Gjithashtu thuhet se personat që veprojnë në veri janë të armatosur, gjë që mendoj se personat që rrinë në barrikada nuk janë të armatosur ose të uniformuar, prandaj mund të thuhet supozimi se mund të jenë të armatosur nuk është i sigurt.

Ndërsa sa i përket Njërive të policisë e cila është vendosur në vende me popullatë të përzier, në raport kjo çështje është përshkruar shumë shkurt, gjithashtu me rastin e Krishtlindjeve Ortodokse dhe incidentet e ndodhura është përshkruar shkurtazi, gjë që vlerësoj se nuk është në rregull pasi janë njëmbëdhjetë polic të suspenduar të cilët kanë tejkaluar kompetencat gjatë arrestimit të truprojave të z. Aleksander Vulin, gjë e cila nuk është përfshirë në raportin e paraqitur, kjo ose për arsye të mos ngarkesës së raportit ose se nuk duhet të përballemi me realitetin, pa marrë parasysh kush ka qenë fajtor.

Ndërsa sa i përket dëmtimit të monumenteve të kultit, gjë e cila është e përfshirë në raport, por përkthimi është i nivelit jo profesional kur trajtohet kjo çështje dhe i pa kuptueshëm.

Anton Quni- Ajo çfarë është kërkuar nga MPB-ja, që të përfshihet në raport ka qenë se, si e vlerëson MPB-ja dhe Policia e Kosovës gjendjen e përgjithshme të Sigurisë në Kosovë dhe përgatitja e Policisë për nivelin e gatishmërisë për menaxhimin e situatave të ndryshme që mund të krijohen gjatë procesit të zhvillimit të bisedimeve në Bruksel, ndërsa kjo pjesë raportit i mungon.

Në këtë rast raporti i Ministrit është shumë më i vonuar se informatat që i marrim nga mediat, prandaj insistoј që të informohemi se cila është gatishmëria e Policisë së Kosovës për menaxhimin e situatave të ndryshme që cenojnë rendin kushtetues, rendit dhe të ligjit, duke kërkuar që të bëhet një raport shtesë në këtë temë.

Nuk është e mjaftueshme që Policia vetëm të konstatoj gjendjen, por më shumë jam i interesuar për veprimet e Policisë, prandaj kërkoj që ky raport të plotësohet deri në takimin e ardhshëm.

Fatmir Xhelili- Për raportin e Ministrit të MBP-së, është pritur më shumë por megjithatë është një përshkrim real i situatës dhe gjendjes në pjesën veriore të vendit.

Në situatat të cilat kanë qenë të pa favorshme për strukturat ilegale dhe për Serbinë, janë marrë aktivitete të dhunshme ndaj popullatës shqiptare si dhe asaj serbe. Ana negative e kësaj shtate qëndron se MPB-ja , është dashur që të insistoj më herët tek EULEX-i, që të ndërmar masat adekuate që efektivat të jenë në veprim të masave parandaluese të zhvillimit të incidenteve, të cilat janë pasqyruar në mediat vendore dhe ato ndërkombëtare se: *“komponentët e shtetit të Kosovës nuk janë të afta për ta kontrolluar këtë territor”*.

Bazuar në kompetencat e EULEX-it, duhet të kemi parasysh se si EULEX-i ashtu edhe Policia e Kosovës janë përgjegjëse për menaxhimin e situatave të ngjashme të hetimit dhe ato parandaluese, por vlerësoj se MPB-ja dhe Policia e Kosovës është dashur të jenë më këmbëngulëse në marrjen e masave adekuate në pjesën veriore.

Gjithashtu nuk mund të anashkalohet indiferenca e KFOR-it, për t’i mbështetur këto dy komponentë, për të mos ardhur deri te bllokimi i rrugëve dhe situatave të ngjashme.

Një sinjal i mirë në këtë situatë është se janë duke u identifikuar qytetarët serb të Kosovës të cilët janë duke i pranuar institucionet e Kosovës dhe janë kyçur për të punuar në zyrën administrative të Kosovës në Veri.

Shpresoj se nga aktivitetet përbashkëta të parapara nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës në fazat e ardhshme, dhe me këmbëngulësi e qëndrimeve politike të EULEX-it dhe organet ekzekutive të saj, situata do të përmirësohet.

Gjithashtu shpresoj se Policia e Kosovës bashke me EULEX-in kanë kapacitetet për të menaxhuar situatën në Veri, por gjithsesi ka hapësirë për atë që do të jetë produkt i dialogut në Bruksel. Duke u bazuar në situatat e tilla të ngjashme, është dashur që masat adekuate të merren me kohë e jo të mbesin në atë se ndoshta dëshira e strukturave ilegale serbe për të vepruar do të zbutet me kohë, dhe është një motiv shtesë tek ta kur janë sinjalizuar se do të kenë mundësi për tu transformuar,duke ndërmarrë veprime adekuate për të faktorizuar vetën duke qenë faktor destabilizues dhe i rrezikshëm.

Nuk besoj se strukturat ilegale serbe janë më të fuqishme se strukturat e shtetit të Kosovës dhe të EULEX-it, prandaj pres që me një aktivitet dhe mbështetje politike të shtuar për këto struktura situata do të menaxhohet.

Ajo çfarë është e rëndësishme është se kemi vazhdim të interesimit të faktorit të brendshëm dhe të jashtëm që gjendja të mbahet nën kontroll, gjithashtu kemi informata MPB-ja, për masat e ndërmarra, informatë e cila që është shumë e përgjithësuar dhe nuk ka vlerësim të incidenteve në mënyrë më përmbytjesore, si dhe kemi vetëm një deklaram se janë ndërmarrë masa për të parandaluar veprimet.

Me vetë faktin se kanë filluar bisedimet dhe e dimë se si është sjell shteti serb në vazhdimësi ndaj Kosovës, është dashur të priten dhe të ndërmerren masa para se të ndodhin incidentet dhe të bëhet një siguri shumë më e madhe nga faktori i brendshëm dhe ai i jashtëm, në rastin konkret nga Policia e Kosovës, instrumentet e sigurisë,

Inteligjenca, EULEX-i, dhe të gjitha mekanizmat të cilat në këtë fazë është dashur të jenë më aktive në mënyrë që të mos lejojnë veprime të tilla.

Duke u bazuar nga vlerësimi ynë për raportin si përshkrues, duhet të kemi një propozim se a do të thërrasim Ministrinë e MPB-së për raportim në Komision apo do të kërkojmë një informatë shtesë, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të detajuar sidomos në angazhimin e MPB-së, Policisë së Kosovës dhe EULEX-it, me qëllim të parandalimit të veprimeve të cilat dëmtojnë imazhin e Kosovës.

Ndërsa informata e cila është kërkuar nga EULEX-i, për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Kosovë e sidomos të pjesës veriore ende nuk ka ardhur, prandaj nuk mund të bëjmë një vlerësim si Komision pa pranuar informatën

Rexhep Selimi- Dua ta saktësoj qëndrimin tim të mbledhjes paraprake. Nuk kamë vërejtje në raportimin e MPB-së, por në mënyrën e të raportuarit apo të informuarit nga ana e tyre. Mbështes qëndrimin Komisionit që të kërkohej informatë shtesë, si dhe raportimin e Ministrit në Komision, por druaj se nuk do të arrijmë më shumë se kaq, sepse qasja e Ministrit ndaj Komisionit po vazhdon të jetë joadekuate për Komisionin si organ mbikëqyrës i punës së këtij institucioni.

Fatmir Xhelili- Raporti i paraqitur nga ana e MPB-së, është si çdo lloj raporti që do të duhej ti paraqitej komisioneve parlamentare, por çështja është tek mbështetja politike, duke filluar nga Komisioni ynë, te komponentët e Policisë së Kosovës, Prokurorisë dhe Gjyqësisë, që t'i ushtrojnë obligimet dhe përgjegjësitë e veta ligjore, duke vepruar aty ku i kanë kapacitetet për të vepruar, duke filluar nga arrestimi i atyre që merren me krim të organizuar, kontrabandë dhe grupe tjera joligjore të krimit që e lidhë pjesën e mbi Ibrit dhe nën Ibrit, që lëvizin të lirë në gjithë Kosovën.

Vlerësoj se organet përgjegjëse të shtetit të Kosovës, kanë nevojë të veprojnë ndajë gjithë atyre pjesëtarëve të organizatave të grupeve kriminale, por kanë nevojë të presin sinjale të posaçëm se kur duhet të filloj arrestimi i tyre.

Komponenti Inteligjente i Policisë së Kosovës ka të dhëna për ata të cilët e kanë thyer ligjin dhe kanë kryer vepra penale, duke filluar nga djegia e portave 1 dhe 31 pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Në bazë të gjitha analizave konstatohet se gjeneratorë kryesorë të incidenteve në pjesën veriore të vendit janë pjesëtarët e këtyre grupeve të cilët ndikojnë dhe në shumë segmente të cilët janë të interesuar për destabilizim në pjesës veriore.

Raporti i Ministrit në raste të tilla do të jetë përshkrues për situatën dhe gjendjen atje, pasi nuk është Ministria ai që ka penguar ndokënd atje për të mos vepruar apo për të shtyrë dikë për të vepruar, por duke filluar nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe gjithë ata që merren me politikë dhe kanë obligime kushtetuese dhe ligjore duhet ta përkrahin Policinë dhe EULEX-in, për të vepruar në pjesën veriore, edhe pse ndoshta EULEX-i, duhet të tregojë nëse është në gjendje për të menaxhuar pjesën veriore apo jo.

Anton Quni- Potencoj edhe një herë se raporti do të ishte mirë të plotësohet më informatat shtesë të cilat i kërkuam, duke u fokusuar në gatishmërinë e Policisë që t'i menaxhojë situatat e jo vetëm t'i konstatojë ato.

Mendoj se Ministri i Punëve të Brendshme duhet të dalë para Kuvendit të Kosovës dhe të ballafaqohet jo vetëm me deputetët të cilët të ngrenë çështjen e sigurisë por edhe deputet e tjerë. Ndajë si Komision duhet të iniciojmë një temë të tillë që Ministri të del para deputetëve dhe t'u jap përgjigjeje pyetjeve të cilat priten të bëhen.

Kryetari i Komisionit- Konstatoj se duhet të plotësohet me informata shitesë raporti i paraqitur, sidomos për marrjen e masave të cilat e stabilizojnë gjendjen dhe duke gjetur formën që Ministri të ballafaqohet me Parlamentin e Kosovës, si institucioni më i lartë të cilit duhet t'i jepet përgjegjësi, por kjo është formë e procedurave të rregullores së Kuvendit.

Ministri i MPB-së, i është ka përgjigjur Komisionit me informata, raporte dhe me paraqitje në Komision, ndërsa përmbajtja e informimit është çështje tjetër. Konsideroj se duhet të përmbushet informata, duhet të ndërmerren veprime që e ndryshojnë dhe përmirësojnë gjendjen dhe njëkohësisht ne si Komision duhet të bëjmë rekomandime për Ministrinë e Punëve të Brendshme, se cilat hapa duhet të ndërmerren, në mënyrë që të ndryshohet gjendja në nivelin e sigurisë në Veri të Kosovës.

Konsideroj se duhet t'i bëjmë disa rekomandime që mund të jenë të dobishme për përmirësimin e gjendjes dhe angazhimin adekuat të Policisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe organeve të tjera të sigurisë. Nëse jeni dakord do të përgatisim rekomandimet dhe do ti dërgojmë një shkresë MPB-së, për të ndërmarr masat e duhura.

Rexhep Selimi- Konsideroj se si Komision, krahas informacioneve, duhet të kemi saktësi në to. Ndërsa, sa i përket çështjes për ta ftuar në raportim Ministrin në Kuvend, kjo çështje nuk mund të iniciohet nga Komisioni. Sidoqoftë do të mund të bënim një iniciativë më konkrete se cila është mënyra që ne të dëgjojmë Ministrin në Kuvend, dhe nëse bëhet e para atëherë për të dytën nuk ka nevojë.

Kryetari i Komisionit- Janë dy mënyra që mund ta ftojme Ministrin për Raportim: janë nënshkrimet nga 6 deputet që mund ta thërrasin Ministrin në interpelancë por në një fazë më të gjatë, ndërsa për seancë të jashtëzakonshme duhen 40 nënshkrime të deputetëve. Kjo mbetet në vullnetin tonë si deputet dhe konsideroj se një paraqitje e Ministrit para Parlamentit në situatën që e kemi do të ishte e domosdoshme, dhe pajtohem që ta bëjmë një gjë të tillë, duke respektuar rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Kjo mund të realizohet nëse është interesimi i deputetëve për ta pasur Ministrin në Seancë.

Fatmir Xhelili- Dua të ndalem te pjesa e propozimit të rekomandimeve eventuale për MPB-në, konsideroj se duhet të jemi më të kujdesshëm, pasi nuk është aq e thjeshtë pa qenë në ngjarje dhe të painformuar mirë të bëhen rekomandime.

Çështja e pjesës veriore është shumë komplekse dhe janë të kyçur shumë faktorë, siç është Brukselit, SHBA-ja, Serbia dhe shteti i Kosovës. Prandaj vlerësoj se mjafton që nga Komisioni të shkohet me propozime për përkrahjen e Policisë, dhe insistimi që EULEX-i dhe KFOR-i të jenë më të angazhuar dhe të jenë në bashkëveprim të drejtpërdrejtë.

Ndërsa sa i përket thirrjes në interpelancë të Ministrit, propozoj që deputetët të mbledhin nënshkrimet në mënyrë individuale dhe grupe nëse dëshirojnë dhe mund të ftohet Ministri. Nuk e konsideroj të arsyeshme që si Komision të përkrahim thirrjen e Ministrit

në interpelancë sepse çdo herë që është ftuar në Komision, Ministri i është përgjigjur ftesës.

Kryetari i Komisionit- Konsideroj se me vullnetin dhe iniciativën e deputetëve mund të ftohet Ministri i MPB-së, gjithashtu konsideroj se sa herë është ftuar në Komision, Ministri i është përgjigjur ftesës, por vlerësoj se në këtë situatë që jemi është i domosdoshëm një debat përmbajtjesor.

Anton Quni- Paraqitja e Ministrit për interpelancë në Kuvend do të ishte e rëndësishme për të raportuar që çështjet të cilat nuk e brenjosin vetëm partinë time, por janë çështje të interesit kombëtar. Duke ikur nga paragjykimet që do të krijoheshin që të iniciohet kjo çështje vetëm nga një subjekt politik, do të ishte më profesionale që paraqitja e Ministrit para Kuvendit të iniciohet nga Komisioni si organ kompetent për mbikëqyrjen e MPB-së. Për disa tema si anëtar të Komisionit nuk kemi ekspertizë dhe kemi deputet që mund t'i trajtojnë ngushtë këto tema, që janë të lidhura me fushën e drejtësisë, liberalizimit të vizave, integriteteve evropiane, financimit etj. Propozoj që kjo çështje të ngjitet nga Komisioni pa paragjykime se si do të jetë rezultati i interpelancës, por me shpresë se ne do të ndikojmë në debat me Ministrin dhe pjesëtarët tjerë të kabinetit qeverisës që ta përmirësojmë performancën e MPB-së.

Kryetari i Komisionit –Konstatoj se gjendja e sigurisë nuk është e mirë, gjithashtu vërehet se ka nevojë për angazhim më të madh të Parlamentit. Prandaj kjo çështje mund të mund të iniciohet sepse ne jemi deputet të Parlamentit dhe nëse kemi vullnetin mirë mund të bëjmë një gjë të tillë, që të ftojme në interpelancë Ministrin.

Debati në Parlament do të ndihmonte për shkak se marrja pjesë e një segmenti të caktuar që mund të mos jetë në Komisionin tonë e që ka të bëjë me Sigurinë, do të ndihmonte që të bëhet një debat më i gjerë dhe të bëhet ndonjë propozim që do të mund të ndihmonte institucionet e Sigurisë në Kosovë që të jenë më aktive.

Është e pakuptimtë se si tërë kohën thuhet se veprojnë institucionet ilegale, krimi i organizuar, kontrabanda, korrupsioni dhe nuk merren masa të cilat i ndalojnë veprimet e tilla. Do të duhet një seriozitet më i madh i organeve të Sigurisë, Policisë së Kosovës, EULEX-it dhe mekanizmave tjerë që nëse ne e vlerësojmë se ka krim të organizuar, kontrabandë, korrupsion, veprime të paligjshme, cenim të kushtetutshmërisë në Kosovë, atëherë këto organe duhet që ata që i bëjnë këto veprime t'i sjellin para ligjit.

Kjo duhet të kërkohet në Parlamentin e Kosovës dhe si Komision do të dakordohemi që një çështje e tillë të paraqitet para këtij parlamenti, ndërsa format dhe procedurat janë sipas rregullores së Parlamentit.

Tutje do të shikojmë mundësinë që në Parlament të debatohet me një fokusim shumë më të madh të deputetëve për të pasur institucion më të mirë të sigurisë, në këtë rast të MPB-së.

Kryetari i Komisionit- Konstatuam si Komision dhe si anëtar të tij se gjendja e sigurisë nuk është e mirë dhe duhet të ndryshohet, andaj si komision e kemi vlerësimin dhe me vullnetin e deputetëve mund të realizohet seanca e cila do të jetë në shërbim të përmirësimit të gjendjes së sigurisë, marrë parasysh faktin se Ministri i MPB-së, ka obligim që të jetë edhe para Parlamentit.

Si Komision e paraqitëm vullnetin tonë por mbetet në vullnetin e deputetëve se sa do ta bëjnë një gjë të tillë.

Rexhep Selimi- Thirrja e Ministrit në interpelancë nuk nënkupton fajësi, nuk duam ta bëjmë meritore apo fajtorë, por ta thërrasim në interpelancë në përputhje me detyrimet dhe obligimet që i ka Ministri për të raportuar në Kuvendin e Kosovës.

4. Njoftim rreth vizitës së delegacionit të Komisionit nga data 4 – 5 mars në Bruksel

Kryetari i Komisionit- Njoftoi për vizitën e realizuar nga ana e disa anëtarëve të Komisionit në Bruksel, nga data 04-05 mars, 2013. Vizita për temë ka pasur: *“Luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe shpëlarjes së parave”*.

Delegacioni nga Kosova ka paraqitur gjendjen në vend, për çështjet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe shpëlarjes së parave, dhe se Komisioni është paraqitur në mënyrë dinjitoze. Gjithashtu gjatë kësaj paraqitje është ftuar Komisioni Evropian për të parë nga afër situatën në Kosovë për këto çështje

5. Të ndryshme

Goran Marinković- Vetëm desha të theksoj se në mbledhjen kur është miratuar procesverbali i mbledhjes së kaluar nuk kam qenë prezent, në të cilin thuhet” se anëtarët më të angazhuar të Komisionit do të përfaqësojnë Komisionin në Bruksel”, për këtë arsye mendoj se si anëtar kam qenë i angazhuar dhe do të doja të dija arsyen e një vlerësimi të tillë.

Kryetari i Komisionit- Arsyeja e parë ka të bëjë se janë përfaqësuar subjektet më të mëdha politike në këtë delegacion, ndërsa e dyta është se z. Marinković është i angazhuar edhe në Komisione të tjera. Përzgjedhja nuk ka qenë tendencioze por qëllimi ka qenë që të marrin pjesë anëtarë që janë më të informuar për çështjet që janë trajtuar në këtë konferencë dhe se numri i pjesëmarrësve ka qenë i përcaktuar nga Parlamenti Evropian.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi